



24.03.2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Zyrtarët e AKP-së u takuan me Kryetarin e Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri me bashkëpunëtorë ku biseduan për Kinemanë e Pejës

Prishtinë - Zyrtarët e Agjencisë Kosovare të privatizimit z.Petrit Ibraj – Drejtor i Koordinimit Rajonal dhe znj.Ardita Lokaj-Menaxhere e ZR Pejë janë takuar sot me Kryetarin e Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri, Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Pejë z.Engelbert Zefaj, Shef i Kabinetit të KK Pejë z.Durim Sheremeti, Drejtori Ekzekutiv të “Anibar” dhe përfaqësues tjerë të shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte diskutimi rreth fillimit të procedurës së likuidimit të Ndërmarrjes për Shfaqjen e Filmave , me konkretisht Kinemaja e Pejës, dhe shqetësimet e ngritura nga shoqëria civile dhe Komuna e Pejës rreth impaktit të Fillimit të Procedurave të Likuidimit në zhvillimin e aktiviteteve Kulturore dhe Artistike në kuadër të Kinemasë në Pejë.

Gjatë takimit përfaqësuesit e Agjencisë së Privatizimit, ri konfirmuan përkrahjen pa rezervë që Agjencia është duke e shfaqur ndaj organizimeve dhe ngjarjeve kulturore dhe artistike në të gjitha Komunat e Kosovës, dhe siguroj përfaqësuesit e Komunës së Pejës, organizatorët e Festivalit “Anibar” dhe ata të shoqërisë civile se Vendosja e Ndërmarrjes për Shfaqjen e Filmave në Likuidim nuk do ta pengoj fare vazhdimin e të gjitha aktiviteteve kulturore dhe artistike në kuadër të Kinemasë në Pejë, për më shumë të njëjtëve iu siguroi se me transferimin e kompetencave Administrative tek Autoriteti përkatës në kuadër të AKP-se, do të ketë përkrahje edhe me të madhe ndaj të gjitha organizatave kontribuese për zhvillimin e aktiviteteve dhe organizimeve të tilla.

Njëherit palët u informuan në detaje rreth procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, dhe faktit se ky është një proces i pashmangshëm drejt transformimit të Ndërmarrjeve shoqërore, proces ky të cilit i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet shoqërore pa përjashtim, mirëpo i cili nuk e kufizon domosdoshmërisht transformimin e të gjitha asetëve vetëm përmes procesit të shitjes.

Krejt në fund të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që gjatë ditëve në vijim AKP dhe Komuna e Pejës do të dalin me një marrëveshje të përbashkët e cila garanton se deri në përfundim të procesit gjyqësor dhe vendimit përfundimtar të gjykatës mbi pronësinë e asetit të Kinemasë në Pejë, ky aset nuk do të tjetërsohet në asnjë formë, dhe deri atëherë AKP dhe Komuna, do të koordinojnë të gjitha veprimet rreth shfrytëzimit dhe organizimeve që do të bëhen në shërbim të aktiviteteve Kulturore-artistike në qytetin e Pejës.

FUND